



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i
Opšte Usluge /Department of Finance and General Services
Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija ljudskih resursa/ human resources division

NJOFTIM PËR PEZULLIM TË KONKURSEVE

Me datën 07.10.2019 Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka pranuar njoftimin nga Ministria e Administratës Publike (më tej: MAP) e cila ka si fushë të përgjegjësisë menaxhimin e Zyrtareve Publik në Republikën e Kosovës.

MAP-i përmes shkresës – Informatë lidhur me zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publik, ofron sqarime për të gjitha Institucionet Publike dhe rekomandon se përderisa Qeveria t'i miratoj aktet e nevojshme nënligjore dhe të marr vendimet e nevojshme në përputhje me Ligjin Nr. 06/L - 114 për zyrtarët publik (LZP), të gjitha veprimet e institucioneve të administratës publike që kërkohet vendimmarrjen e Qeverisë në lidhje me pranimin (rekrutimin), ngritjen në detyrë dhe lëvizjen brenda kategorisë duhet të pezullohen.

Andaj, nga të cekurat si më lartë, divizioni i burimeve njerëzore njofton te gjithë aplikantet për pezullimin e konkursit të jashtëm për pozitat e poshtëshënuara:

1. Zyrtar i lartë i prokurimit - PR/020 në kuadër të Divizionit të Prokurimit
2. Zyrtar i Lartë Ekzekutiv - AD/260 në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm

Të publikuar me datën 11.09.2019 i mbyllur me date 02.10.2019 në ueb faqen e MZHE-së, tabelën zyrtare të shpalljeve në ministri, si dhe gazetata ditore “Bota sot” dhe “Zëri” , si dhe pozita:

1. Zyrtari i Lartë për politika dhe strategji minerare - EZHE/280 në kuadër të Divizionit të Politikave Minerare në Departamentin e Minierave

e publikuar me datën 12.09.2019 i mbyllur me date 03.10.2019 në ueb faqen e MZHE-së, tabelën zyrtare të shpalljeve në ministri, si dhe gazetata ditore “Koha ditore” dhe “Epoka e Re”

PEZULLOHEN deri në miratimin e rregulloreve për zbatimin e Ligjit Nr. 06/L - 114 për zyrtarët publik (LZP) nga Qeveria e Kosovës.